



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

PROGRAMI I LËNDËS
Drejtimi : Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore

TITULLI I LËNDËS: EKONOMIKS

Pedagogu: Ma. Parashqevi Petromilo
Ngarkesa: 4 ETCS, (30 leksione dhe 15 seminare)
Lloji i lëndës: me zgjedhje
Programi i studimit : bachelor
Viti/Semestri: II/I

EKSTRAKT: Përqëndrim i vëmendjes kryesore dhe kuptimit të termave, kategorive, ligjeve, instrumentave dhe politikave ekonomike, që trajtohen teorikisht në literaturë (makroekonomi) ose aplikohen në veprimtarinë e përditshme të ekonomive të zhvilluara të tregut (mikroekonomi). Sqarimi i koncepteve thelbësore që përmbledh fusha e ekonomiksit dhe përshtatja e këtyre koncepteve për studentët e degës së historisë, me qëllim që termat bazë ekonomike që do të hasin ata gjatë studimeve të tyre të jenë të kuptueshme dhe ata të familjarizohen me to. Do të kihet parasysh trajtimi i termave dhe koncepteve të stabilizuara dhe të vlerësuara shkencërisht dhe jo teorive të reja apo hipotetike, që mund të konfundojnë studentët. Gjatë fokusimit të qëllimit të lëndës është patur parasysh të sigurohet një vazhdimësi midis pjesëve të ndryshme dhe të mbulohen të gjitha objektivat e programit të lëndës. Materiali mësimor është përpunuar në atë mënyrë që të mund të lejojë trajtimin ciklik të kategorive, me qëllim që të arrij të krijojë njohuri të qendrueshme tek studentët.

TEMAT:

LEKSION 1: Vështrim i përgjithshëm mbi Shkencën e Ekonomisë. Ç'është Ekonomiksi. Kufiri i mundësive të prodhimit dhe kostoja oportune. Pamje e përgjithëshme e ekonomisë së tregut. Përse është e nevojshme njohja e ekonomiksit. Metodologjia e shkencës ekonomike.

LEKSION 2: Kërkesa, Oferta, Ekuilibri i tregut. Kërkesa dhe kurba e kërkesës. Oferta dhe kurba e ofertës. Ekuilibri i tregut. Ndryshimi i kërkesës, ofertës dhe i ndryshimit të njëkohshëm të tyre, në çmimin dhe sasinë e ekuilibrit. Disekuilibri. Elasticiteti i kërkesës lidhur me çmimin. Faktorët që përcaktojnë elasticitetin e kërkesës lidhur me çmimin.

LEKSION 3: Firmat. Firma dhe objektivat e saj. Llojet e firmave. Rrugët e rritjes së kapitalit nga firmat. Kontabiliteti i firmës. Bilanci dhe pasqyrat e rezultatit financiar.

LEKSION 4: Kostoja. Kostot në periudhat afatshkurtëra. Kostua oportune. Kostua në periudha afatgjata.

LEKSION 5: Monopoli. Monopoli dhe tiparet e tij. Kurba e kërkesës dhe maksimizimi i fitimit në firmën monopol. Efienca në kushtet e monopolit dhe kritika e tij. Diskriminimi i çmimeve në kushtet e monopolit. Politikat shtetërore për kontrollin e monopolit.

LEKSION 6: Shpërndarja e të ardhurave. Bazat teorike të shpërndarjes së të ardhurave. Paga si çmim i faktorit punë. Renta si çmim i tokës. Interesi si çmim i kapitalit.

LEKSION 7: Sektori publik. Përse është e nevojshme ndërhyrja e shtetit në ekonomi. Sektori publik dhe përmasat e tij. Financimi i sektorit publik. Zgjedhja publike.

LEKSION 8: Hyrje në makroekonomi. Makroekonomia si degë e Ekonomiksit. Një vështrim i shkurtër teorik. Konceptet kryesore makroekonomike. Objektivat kryesore makroekonomike dhe mjetet politike të realizimit të tyre. Instrumentat kryesore të analizës ekonomike. Matja e produktit të përgjithshëm, rëndësia dhe problemi i agregimit. Mënyra e matjes së produktit të përgjithshëm dhe treguesit përkatës. Disa identitete të rëndësishme makroekonomike. Produkti kombëtar dhe mirëqënia ekonomike. Kërkesa agregate dhe faktorët përcaktues të saj. Oferta agregate dhe faktorët përcaktues të saj. Ekuilibri makroekonomik. Modeli klasik dhe ia kensjan.

LEKSION 9 : Konsumi dhe Investimet. Konsumi dhe Kursimi. Të ardhurat e disponueshme dhe funksioni i konsumit. Faktorë të tjerë përcaktues të konsumit. Investimet dhe faktorët përcaktues të tyre.

LEKSION 10: Shpenzimet dhe të Ardhurat. Shpenzimet agregate dhe GDP Real. Investimet dhe kursimi. Multiplikatori i shpenzimeve. Multiplikatori i politikës fiskale. Multiplikatori i ekonomisë së hapur.

LEKSION 11: Ciklet e biznesit dhe Rritja ekonomike. Ciklet e biznesit dhe fazat e saj. Disa teori të ciklit të biznesit. Rritja ekonomike.

LEKSION 12: Inflacioni. Kuptimi i inflacionit. Llojet e inflacionit. Kostot e Inflacionit.

LEKSION 13: Papunësia. Papunësia, matja e papunësisë dhe kostot e saj. Interpretimi ekonomik i papunësisë dhe llojet e saj. Norma natyrore e papunësisë.

LEKSION 14 : Paraaja dhe Sistemi Bankar. Paraaja dhe funksionet e saj. Komponentët e ofertës monetare dhe kërkesa për para. Bankat, llojet e tyre dhe procesi i krijimit të depozitave. Banka Qendrore dhe Politika Monetare. Funksionet e Bankës Qendrore dhe instrumentat e politikës monetare. Tregu monetar dhe mekanizmi i politikës monetare. Rryma monetariste dhe veçoritë e saj.

LEKSION 15: Politika fiskale. Buxheti qeveritar dhe politika fiskale. Ndërveprimet e politikave monetare dhe fiskale. Pasojat ekonomike të borxhit qeveritar.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI: 70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

40 % e notës përfundimtare

DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

LITERATURA:

AHMET MANÇELLARI, SULO HADËRI, DHORI KULE, STEFAN QIRICI. *HYRJE NË EKONOMI.*

RUDIGER DORNBUSCH, STANLEY FISCHER *MAKROEKONOMIA*